



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANGAZHIMIN SI ANËTAR I
KOMISIONIT LIGJOR PRANË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786 datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, njofton të gjithë të interesuarit të paraqesin kërkesën e tyre për Anëtar të Komisionit Ligjor të ngritur pranë BMP.

Të interesuarit duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:

- Të kenë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master” ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudencës, të cilat duhet të jenë të lidhura me auditimin, kontabilitetin dhe financën, me përvojë profesionale jo më pak se 7 vite përvojë pune.

Gjithashtu, duhet të:

- a) jenë shtetas shqiptarë;
- b) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- c) të mos kenë konflikt interesi me anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike apo strukturat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së komisionit;
- ç) të mos jenë të angazhuar në role apo funksione politike;
- d) të mos jenë në strukturat/këshillat drejtuese të më shumë se një nga organet/institucionet/organizatat e parashikuara në ligjin 10091/2009 që lidhen drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me përzgjedhjen dhe veprimtarinë e Komisionit Ligjor.

Personat e interesuar duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm deri në datën 30.03.2023 pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

- Letër motivimi;
- CV;
- Fotokopje e diplomës së nivelit Master;
- Reference pune.

Duke ju falënderuar!

Bordi i Mbikëqyrjes Publike